



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. 1867/Prot.
3

Pogradec, më 19.05.2025

VENDIM

NR. 42, DATË 16.05.2025

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 29.04.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 29.04.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 29.04.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 16 vota

2.Vota Pro 16

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 19.05.2025



ORA : 12:00

JANË PREZENT 19 KËSHILLTARËPROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 29.04.2025, ME KËTË REND DITE.

1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.
2. Projekt – Vendim : Miratimi i Procesverbalit të datës 11.04.2025.
3. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 11.04.2025.
4. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2024.
5. Projekt – Vendim: "Për miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit strategjik me titull " Circle" në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, programi I bashkëpunimit ndërkufitar Greqi- Shqipëri 2021-2027"
6. Projekt – Vendim: Për miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit me titull " Sistem informative paralajmërues për mbikëqyrjen hidrometerorologjike tokë-ujë." Në kuadër të programit ndërkufitar, interreg (VI) IPA CBC " GREQI- SHQIPËRI 2021-2027"
7. Projekt – Vendim: "Për miratimin e tarifës së shërbimit të ujitjes së tokave bujqësore"
8. Projekt – Vendim: Për dhënien e bonusit të qerasë për z. Agron Cela në Bashkinë Pogradec.
9. Projekt – Vendim: "Miratimin e Planit Lokal të veprimit për rininë në Bashkinë Pogradec"

10. Projekt – Vendim: Për miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullosore: "Golik-Kalivac", "Vërri-Debrovë", " Petrushë- Lin ", "Guri Top- Gjëmth", "Dunicë -Llëngë" dhe "Nicë –Valamarë", dhe kontratës tip

11. Projekt – Vendim: Për miratimin e kryerjes së investimit me object " Pastrimi, Grumbullimi dhe largimi I mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative"

Pv shtese:

1.Per miratimin ne parim te dhenies me qira ,ne favor te individve kerkues per ngritje fidanishte ,te pasurise me siperfaqe totale 20400m².

2.Per miratimin e listes se siperfaqes se tokes prej 20.85 ha,e ndodhur ne njesine administrative Cerrave,qe mund te jepen me qira.

1.Projekt – vendim :”Miratimi I Rendit të ditës”.

Diskutime

M.Kamolli:

Pershendetje te gjithve!Jemi mbledhur ne takimin e radhes per te zhvilluar mbledhjen e keshilit per muajin prill 2025.Materialet I kini mare si ne menyre elektronike ashtu edhe fizikisht.Jane prezent 19 keshilltare,mbledhjen e deklaroj te hapur.

Nese dikush nga keshilltaret ka konflikt interesi me ndonje nga pikat e rendit te dites ju lutem deklarohuni.

Pika nr.7 e rendit te dites ka nje ndryshim ne titull.Do te jete: ‘Për një ndryshim në Vendimin nr. 25 datë 27.03.2025 të Këshillit Bashkiak “ Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile” .

Ne mbledhjen e komisioneve u arrit ne konkluzionin qe pika nr. 10 do te kaloj ne konsultim public.,po ashtu pika nr.12 dhe 13.

K.Topa:

Nga mbledhja e komisioneve dolem ne perfundim se pika nr.10 ,12 dhe 13 do te kalojne ne konsultim public sipas rregullores ne fuqi ,ndersa pika nr.11 e rendit te dites per shkak se materiali nuk eshte paraqitur ne keshill deri ne afatin e percaktuar ,eshte vendosur te hiqet nga rendi I dites.

M.Kamolli:Atehere e hedhim ne votim rendin e dites me te gjitha ndryshimet qe u thane.



U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____.____. 2025

2. Pika nr ____ : “Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 11.4.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec” .

M.Kamolli :Vazhdojme me miratimin e procesverbalit te dates 11.04.2025.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Diskutime



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____.____. 2025

4.Pika nr ____: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2025.
Diskutime

M.Kamolli:Vazhdojme me project-vendimin e 6%.Ky eshte nje project – vendim qe ne e miratojme cdo muaj ne keshill.

Znj.Mancellari :Pershendetje!

Do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin Mars 2025 gjithsej 174 familje me fond 720227 leke.

M.Kamolli :Ka ndonjeri nga keshilltaret dicka per te shtuar ?
Atehere ju ftoj ta hedhim ne votim piken nr 4 te rendit te dites.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



5. Projekt-vendim: "Për miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit strategjik me titull " Circle" në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, programi I bashkëpunimit ndërkufitar Greqi- Shqipëri 2021-2027"

Diskutime

M.Kamolli:Vazhdojme me piken nr 5 te renditt te dites .

Pergjegjsja e projekteve znj.B.Como do na shpjegoj ne vija te pergjithshme project-vendimin ne fjale.


B.Como:Ne kemi sjelle 2 projeke per miratim.

Projekti I pare eshte domosdoshmeri qe te miratohet ne keshill per te vazhduar me pas rrjedhen e tij.

Partner në këtë project janë:

- 1.WASTE MANAGEMENT OF WESTERN MACEDONIA Salider projekti Greqi
- 2.HELLENIC RECYCLING AGENCY partner Greqi
- 3.Bashkia Pogradec partner Shqipëri
- 4.Bashkia Fier partner Shqiperi.

Vlera totale e projektit për të dyja palët shqiptare dhe greke është:
1.800.000 euro



Buxheti për Bashkinë Pogradec është 394.616 euro nga të cilat: 315.692,20 euro kontribut i BE dhe 78.692,80 euro bashkefinancim i Bashkise Pogradec.

Bazuar në buxhet, Bashkia Pogradec ka detyrimin e kostos së bashkefinancimit të projektit dhe TVSH-së.

Ky projekt ka të bëjë me nxjerrjen e algave nga liqeni dhe mbeturinat e tjera. Është menduar që të blihen disa makineri të cilat do të ndihmojnë në realizimin e këtij projekti.

Përfitimet që sjell zbatimi i këtij projekti:

-Shmangia e ndikimit negative në turizëm

Mbledhja e këtyre algave, depozitimi i tyre në një vend të dedikuar për riciklim do të ndikojë në ruajtjen dhe mbrojtjen e ekosistemit, duke mundësuar një mjedis më të pastër të bregut të liqenit të qytetit të Pogradecit, duke qenë një qytet turistik i vizituar në katër stinët e vitit. Prania e tyre mund të shkaktojë një pamje të padëshirueshme dhe të kufizojë përdorimin e bregdetit nga njerëzit. Pastrimi i tyre mund të ndihmojë në ruajtjen e atraktivitetit të zones për turistët dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

-Kultivimi i tyre mund të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ujit:

Algat e mbledhura nga bregu i liqenit zakonisht janë të dekompozuar dhe mund të shkaktojnë problem të cilësisë së ujit nëse nuk trajtohen.

-Përpunimi i tyre ndikon në përmirësimin e estetikës dhe shfrytëzimit të bregut të liqenit:

-Parandalimi i ndotjes së ajrit:



Algat e vdekura mund të shkaktojnë një shkallë të lartë dekompozimi, duke lëshuar gazra të ndryshëm në ajër, duke përfshirë squfurin dhe amoniakun.

Përfitim financiar.

Duke qenë në pronësi të Bashkisë Pogradec këto makineri do shmangin koston që paguan deri tani Bashkia për kontraktimin e subjekteve që realizojnë pastrimin e bregliqenit.

F.Pikuli:jemi shpejt per ta miratuar .Ketu thote per intervalin kohor 2025-2027.

Eshte risku qe te mos miratohet.

B.Como:Shancet qe te miratohet eshte 90% sepse I kemi kaluar fazat dhe kemi partneritet.

M.Kamolli:E hedhim ne votim piken nr .5 te rendit te dites.

U votua

Pro 17

Kundër 1

Abstenim 1

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____.____. 2025

6.Projekt – Vendim: Për miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit me titull " Sistem informative paralajmërues për mbikëqyrjen hidrometeorologjike tokë-ujë." Në kuadër të programit ndërkufitar, interreg (VI) IPA CBC " GREQI- SHQIPËRI 2021-2027"

M.Kamolli:vazhdojme me project-vendimin e radhes.

B.Como:Bashkia ka aplikuar dhe vlere e projektit eshte 29.988 euro dhe Tvsh. Projekti financon blerjen e nje paisje te paisur me nje system te integruar Informacioni ,per monitorimin dhe mbikqyerjen hidro-meterologjike te tokes. Do te blihet nje kamjon I cili do te perdoret per ted y projektet.

F.Pikuli:A jemi ne vleresues te ketij impakti?

M.Kamolli:Nese ju mendoni qe ky project nuk ka vlere na thuaj arsyet ,por une mendoj qe ne duhet t'i hapim rrugen dhe te perkrahim cdo gje te re qe mund te na ndihmoje ne mirmbajtjen dhe mirfursionimin e qytetit tone.

B.Comp:Ju duhet te shini sesa I rendesishem eshte blerja e ketij kamjoni. Sistemet e paralajmerimit te hershem te rrezikut mund te shpetojne jete njerzish dhe prona.

Blerja e ketij kamjoni transportues ka qene evidentuar dhe prezantuar nga NMI-ja.

Kjo makineri do te ndihmoje per nxjerjen e algave nga liqeni dhe transportimin e tyre.

M.Kamolli :Une mendoj ta hedhim ne votim piken nr.6 te rendit te dites.

Ora 12:20 vjen M.Biba

U votua

Pro 18

Kundër 1 FREDI

Abstenim 1 IIRIA

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____. 2025

7. Projekt – Vendim: “Për miratimin e tarifës së shërbimit të ujitjes së tokave bujqësore”.

Diskutime

M.Kamolli :Projekt –vendimi I radhes eshte per miratimin e tarifes se sherbimit te ujitjes te tokave buqesore.

Jolka Doko:Ndryshimi nuk eshte tek tarifa e sherbimit te ujitjes se tokave buqesore por tek istitucionet qe do te marin kete sherbim.Deri tani kjo tarife eshte vjele nga vete fermeret . Momentalisht, shërbimi është kryer nga organizatat e fermerëve në zonat e shërbimit, duke menaxhuar sasinë e ujit në rezervuarë dhe duke publikuar vetëm një tarifë për sasinë e ujit të përdorur. Situata në këtë sektor realisht ka ardhur duke u përkeqësuar dhe ky shqetësim është shprehur vazhdimisht nga fermerët dhe momentalisht kërkesat dhe ankesat e fermerëve paraqesin një situatë shumë kritike .

Këto organizata nuk po mundën të menaxhojnë shërbimin e furnizimet me ujë për vaditje, duke pasur pakënaqësira edhe për cëshjen e tarifave të cilat nuk kanë transparencë por edhe ka sjellë dëmtime të sistemit të ujitjes dhe kullimit deri në atë fazë sa tashmë kemi të pamundur të menaxhojmë kërkesat në rritje të infrastrukturës së vaditjes me investime për ta pasur atë në gjendje optimale.

Pavarësisht se sistemet menaxhoheshin nga organizatat e ujitjes së fermerëve, nga ana jonë janë kryer vazhdimisht ndërhyrje në



mirëmbajtje dhe investime të infrastrukturës së vaditjes me fonde të transferuara por edhe me fonde të bashkisë.

Sot nga një vlerësim paraprak edhe për shkak të pakësimit të burimeve ujore të cilat furnizojnë sistemin e vaditjes, por sidomos nga keqmenaxhimi i sasive të ujit që ndodhen në rezervuarë, rezulton që një pjesë e mirë e ujit të rezervuarve keqpërdoret duke mos shkuar atje ku janë nevojat. Edhe fermerët e shprehin këtë shqetësim, duke theksuar se nëse do ketë mirëmenaxhim të sasive të gruambulluara do ishin të mjaftueshme për të vaditur tokat bujqësore të cilat janë të pajisura me sistem vaditjeje.

F.Pikuli;

Jane evidentuar problemet ,por car eshte bere?

J.Doko:

Në këtë situatë,duke konsideruar edhe faktin se pavarësisht se organizatave ju është lënë një kohë e konsiderueshme për tu formalizuar dhe për të vepruar sipas parashikimeve ligjore (regjistrimi ne gjykatë, miratimi i statuteve dhe akteve të themelimit, funksionimi i bordeve dhe miratimi i tarifave,auditim të shpenzimeve nga Bashkia etj, të gjithë dispozita të përcaktuara nga ligji i mësipërm nenet 21, 26, 27, 28-37, 38, 42, 43, 46),ato sot funksionojnë përsëri të paformalizuara dhe është e pamundur kontrolli i kryerjes së shërbimit si dhe duke konsideruar faktin se jemi në një situatë emergjente përpara sezonit të vaditjes masive të bimëve, kërkojmë që Bashkia të marrë funksionin e plotë të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sistemeve të vaditjes dhe kullimit për ta kthyer atë ne standartet ligjore dhe për të shmangur mungesën e ujit në tokat bujqësore të fermerëve.



F.Pikuli:Sa fermere do te vaditin me kete uje?

Jolka:Ne nuk mund te dime kush do vadit dhe sa ngastra toke ,por dime sa toke do te vaditet ne teresi.

Lushe:Ne qe meremi perdite me ate pune e dime sa i rendesishm eshte ky project,ndaj do te thoja qe ky project eshte shume ii nevojshem per fermeret.

M.Kamolli :Ne po zgjidhim nje problem te banore dhe per mendimin tim ky eshte nder project-vendimet me te sqaruara.

Liri Seitllari:Une shoh tekstin dhe ky project–vendim nuk ka kuptim keshtu si ka ardhur.

K.Topa:Pergjegjsja ka sqaruar cdo fjale te prjekt vendimit ne relacion,ndaj ju lutem kushtoini vmendje relacionit dhe materiali te paraqitur ne keshill.Flet qe kini perpara eshte vetem ndryshimi I titullit te project-vendimit.

Deri me sot taksat per ujin qe perdoret per vaditje I ka vjele organizata,sot po kerkohet t’I vjeli bashkia me kerkese te banorve.

M.Kamolli ;Ju lutem koleg ta hedhim ne votim piken nr .7 te rendit te dites.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 1 Fredi

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____.____. 2025

8. Projekt – Vendim: Për dhënien e bonusit të qerasë për z. Agron Cela në Bashkinë Pogradec.

Diskutime

M.Kamolli: Vazhdojme me dhënien e bonusit të qeras për z. Agron Cela.
Edhe kjo bonus qeraje është bonus në vazhdimsi.
Nëse nuk keni dicka për të shtuar ju lutem ta hedhim në votim

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

9.Projekt – Vendim: Miratimin e Planit Lokal të veprimit për rininë në Bashkinë Pogradec"

M.Kamolli

Miratimi planit local eshte project-vendimi I radhes.

Sipas procedurave te nevojshme eshte zhvilluar konsultimi public me te gjitha grupet e interest,te cilet dhane impaktin e tyre per ceshtjen ne fjale.

E pergezroj dhe uroj stafin per punen productive te cilen kane kryer.

K.Topa:Ky Projekt-vendim sic e dime te gjithes eshte kaluar ne konsultim public .Ne konsultim public kane mare pjese te gjitha grupet e interest .

Hasem nje problem qe te rinjt nuk ishin njohur me materialin paraprakisht ,por u la nje afat kohor prej ditesh per te sjelle sygjerimet e tyre per projectin ne fjale.Deri ne momentin qe flasim nuk ka ardhur askush me nje sygjerim,per ta pasqyruar ne plan .

Loredana:Ky plan ka dal si rezultat I konsulences me te rinjt ,duke nxitur ndermarjen e veprimeve active ne fushen sociale,ekonomike,politike dhe vendimarse.

Nje document strategjik sic eshte ky plan identifikon problemet,nevojat dhe prioritetet e te rinjve ne ceshtjet sociale dhe ofrimi ii zgjedhjeve te mundshme ,nepermjet ofrimit te mekanizmave,menyrave dhe mjeteve te caktuara per te adresuar dhe zgjedhur problematikat e evidentuara .

M.Kamolli:Ju lutem ta hedhim ne votim piken nr 9-te rendit te dites.

U votua

Pro _____20_____

Kundër _____0_____

Abstenim _____0_____

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____.____. 2025

10.Projekt – Vendim: Për miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullosore: "Golik-Kalivac", "Vërri- Debrovë", " Petrushë- Lin ", "Guri Top- Gjëmth", "Dunicë -Llëngë" dhe "Nicë –Valamarë", dhe kontratës tip



Mbledhje e Këshillit Bashkiak


Pogradec më _____.____. 2025

11. Projekt – Vendim: Për miratimin e kryerjes së investimit me object " Pastrimi, Grumbullimi dhe largimi I mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative"

U votua

Pro _____
Kundër _____
Abstenim _____

Miratohet Po Jo



1. Per miratimin ne parim te dhenies me qira ,ne favor te individve
kerkues per ngritje fidanishte ,te pasurise me siperfaqe totale
20400m2.

U votua

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

Miratohet Po Jo



2. Per miratimin e listes se siperfaqes se tokes prej 20.85 ha, e ndodhur ne njesine administrative Cerrave, qe mund te jepen me qira.

U votua

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

Miratohet Po Jo